



EKONOMIA E USHQIMIT - BUJQËSIA



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001



EKONOMIA E USHQIMIT



PËRMBAJTJA

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

AVANTAZHET, MUNDËSITË DHE PRIORITETET

SEKTORI I BUJQËSISË

TABELA NR.1. STRUKTURA E MBJELLJEVE E BIMËVE TË ARAVE VITET 2005 -2020 SIP. NË 000/HA

TABELA NR.2 PRODHIMI I BIMËVE TË ARAVE, 2015-2020 (NË 000 TON)

TABELA NR.3 SIPËRFAQE E KULTIVUAR ME PERIME GJITHËSEJ, 2014-2020 (NË HA)

TABELA NR.4 PRODHIMI I PERIMEVE GJITHËSEJ, 2014-2020 (NË TON)

TABELA NR.5 NUMRI I RRËNJËVE, PRODHIMI DHE RENDIMENTI I DRUFRUTORËVE, 2010-2020

MEKANIZIMI, INOVACIONI DHE DIGJITALIZIMI NË SEKTORIN E BUJQËSISË

BLEGTORIA

TABELA 6. NUMRI I KRERËVE TË BAGËTIVE 000/KRERË PERIUDHA 2013 -2020

TABELA 7. PRODHIMET BLEGTORALE 000/TON PERIUDHA 2013 -2020

PESHKIMI DHE AKUAKULTURA

TABELA NR. 8 ZËNIE PESHKU SIPAS KATEGORIVE UJORE 2016 -2020

TABELA NR. 9 FLOTA DETARE SIPAS LLOJIT TË ANIJES 2016 – 2020

AGROBIZNESI

TABELA NR.10 QENDRA TË GRUMBULLIMIT TË PRODUKTEVE NË SHKALLË VENDI SIPAS RAJONEVE

TABELA NR. 11 TË DHËNA PËR TREGJET E SHUMICËS SIPAS QARQEVE

AGROPËRPUNIMI

BIMËT MJEKËSORE, AROMATIKE DHE BLETARIA

SEKTORI I BLETARISË

AGROTURIZMI, AGROPYLLTARI DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE

TABELA NR. 12 SUBJEKTET E LICENSUARA TË AGROTURIZMIT

AGROPYLLTARIA DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE

TREGJET AGRO BLEGTORALE

FINANCIMI, MIKROFINANCA DHE PËRMIRËSIMI I LEGJISLACIONIT ME IMPAKT TË DREJTËPËRDREJTË NË ZONAT RURALE.

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

AVANTAZHET, MUNDËSITË DHE PRIORITETET

Shqipëria ka patur dhe do të vazhdojë të ketë si prioritet kryesor edhe në të ardhmen, përmirësimin dhe konsolidimin e veprimtarisë në sektorin e Bujqësisë, si një ndër sektorët kryesorë të Ekonomisë së Ushqimit. Realizimi i objektivave në këtë sektor, përveç faktorëve të tjerë, aktualisht është i lidhur ngushtë dhe kushtëzohet edhe nga zhvillimi i procesit të bashkëpunimit dhe koordinimit me hallkat e tjera të zinxhirit ushqimor. Siç janë “Blegtoria”, “Peshkimi dhe Akuakultura”, “Agrobiznesi”, “Agropërpunimi”, “Bimët Mjekësore, Aromatike dhe Bletaria”, “Agroturizmi, Agropylltaria dhe Mjedisi në zonat rurale”, “Tregjet Agro-Blegtorale”, “Financa, Mikrofinanca dhe përmirësimi i legjislacionit që ndikon zonat rurale”.

Toka bujqësore, uji, klima, livadhet, kullotat, pyjet, mjedisi, energjia, mekanizimi dhe inovacioni, financat dhe legjislacioni, janë faktorë me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë, gjithashtu edhe për rritjen e stabilitetit të Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

Shqipëria ka gjithësej 2.8 milion ha tokë nga e cila: 699.021 ha është tokë bujqësore ose 24 % e totalit që është kultivuar në vite, ndërsa livadhet e kullotat zënë 16 %, tokat (jo produktive, urbane, sip. ujore të brendshme) zënë 15 %, pyjet 36 % dhe të tjera 9 %.

Shqipëria, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë renditet ndër vendet me sipërfaqen më të vogël të tokës bujqësore për numër banorësh, por njëkohësisht renditet si më e pasura në Ballkan dhe më gjerë për hidrografinë, për burimet dhe rezervat e pastra ujore. Ajo ka 6 laguna të përmasave të ndryshme, 5 liqene të përmasave të mëdha dhe 247 liqene artificiale të llojeve dhe përmasave më të vogla. Gjithashtu janë evidentuar mbi 200 burime ujore nëntokësore, me një prurje mesatare gjithëvjetore prej 200 l/sek secili.

Relievi i tokës bujqësore, infrastruktura e ujitjes dhe potenciali i pasur ujqor i ka mundësuar dhe i mundëson Shqipërisë ujitjen e mbi 400 mijë ha tokë bujqësore. Shqipëria ka potenciale dhe disa avantazhe për të qënë konkurruese në fushën e eksporteve të prodhimeve bujqësore, por edhe disa prodhime nga hallka të tjera

të Ekonomisë së Ushqimit, përveç potencialeve ujore, ekzistojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë pozitiv ndër të cilët përmendim:

- Klima mesdhetare me mbi 300 ditë në vit me diell, me rreshje mesatare vjetore që variojnë nga 722 mm deri në 2750 mm. Rreshjet e shiut dhe dëborës variojnë nga 120 – 135 ditë/vit. Pozicioni gjeografik i favorshëm bën që Shqipëria të lagjet nga dy dete, Adriatik dhe Jon. Vija bregdetare është me gjatësi 450 km përfshirë Lagunat. Klima, uji dhe toka bujqësore favorizon ndjeshëm kultivimin e perimeve dhe prodhimin e frutave, agrumeve, drufrutorve, etj, e cila mundëson daljen në treg në pranverë një muaj përpara konkurrentëve në vendet e rajonit.
- Shumë fermerë e përdorin tokën për të plotësuar vetëm nevojat e tyre të blegtorisë, por një numri jo të vogël nga këta fermerë, ju mbetet edhe një tepricë produktesh për nevoja të tregut të vendit. Gjithashtu një pjesë e fermerëve të mbetur, kanë investuar dhe janë në proces investimesh në bujqësi në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor, për të prodhuar produkte për tregun vendas dhe për eksport.
- Fermerët në Shqipëri, për disa arsye subjektive, kanë lënë një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore, të pa kultivuar në vite. Kjo tokë është mjaft produktive, e pa kontaminuar, e mundur për t'u ujitur dhe punuar me mekanikë bujqësore. Sipërfaqe të konsiderueshme toke në kodra janë të përshtatshme për rritjen e pemëve frutore, ullinjve, vreshtave dhe agrumeve. Pyjet, kullotat dhe livadhet janë të përshtatshme për mbarshkrimin e kafshëve, shpendëve, kultivimin e bimëve medicinale dhe prodhimin e frutave të pyllit. Këto sipërfaqe të lira toke mund të përdoren në masë të madhe edhe për të rritur sasinë e prodhimeve organike. Tokat e pakultivuara i përkasin shtetit dhe grupimit të parë të fermerëve (fermerë që e përdorin tokën për nevoja personale), të cilët zënë 82 % të numrit total të fermerëve të regjistruar si të tillë.


- Burimet ujore dhe ato nëntokësore në veçanti, nuk shterojnë gjatë gjithë vitit. Ato janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Shumë prej tyre plotësojnë standardet e cilësisë për t'u konsumuar direkt nga burimi si nga njerëzit dhe nga kafshët, përveç përdorimit për ujë.
- Zonat e mbrojtura në Shqipëri vlerësohen për potencialet që kanë për zhvillimin e agroturizmit, bletarisë, prodhimit të bimëve medicinale, të frutave të pyllit, për sportet dhe gjuetinë rekreative. Ato zënë një sipërfaqe toke të konsiderueshme prej 523, 831 ha.
- Flora dhe fauna e tyre është mjaft e pasur dhe e shumëllojshme, në të cilat rriten rreth 3, 221 lloje të ndryshme bimësh. Gjithashtu rriten në mënyrë natyrale e kultivohen rreth 330 specie bimë medicinale dhe aromatiko-vajore dhe prodhohet edhe një gamë e gjerë me fruta pylli natyrale.
- Fauna gjithashtu është shumë e pasur. Pas një moratoriumi kombëtar disa vjeçar, aktualisht po shtohen në sasi e rritet një shumëllojshmëri shpendësh e kafshësh të egra si: Ariu Murrëm, Ujku, Kunadhja, Dhelpra, Çakalli, Dhia e Egër, Derri i Egër, Kaprolli, dy lloje Macesh të Egra, Rreqbulli e Vjedulla, 14 lloje Lakuriqe nate dhe rreth 350 lloje zogj vendas, dy lloje të rralla të Gjelit të Egër dhe Qukapikut. Po shtohen edhe disa lloje zogj grabitqar si Shqiponjat, Fajkonjtë, Hutat, Skifterët dhe disa lloje bufi si Bufi me Mjekër, Bufi me Bri dhe Kukuvajka e vogël.
- Zona rurale në Shqipëri, në dallim nga shumë vende të zhvilluara vazhdon akoma të jetë shumë e populluar. Banorët kanë bërë investime të konsiderueshme në banesa të reja dhe rikonstrukcionin e atyre ekzistuese. Aktualisht, në këto zona, në mbi 2, 500 fshatra banojnë rreth 40 % e popullsisë së vendit, e cila vazhdon pa i ndërprerë investimet.



Qeveria ka përzgjedhur si pikënisje për të mbështetur me prioritet investimet në 100 fshatra në të 61 bashkitë të vendit, duke përfshirë gjithë territorin e zonave rurale, dhe po zbaton prej disa vitesh këtë projekt, me synim për t'i paraprirë zhvillimit të agroturizmit, si dhe përdorimit me efikasitet të të gjitha burimeve që Shqipëria disponon.

Kontributi i hallkave kryesore të Ekonomisë së Ushqimit është rreth 18,9% në PBB-në e vendit tonë (në 2019) dhe mbulon 36,4% të punësimit të përgjithshëm. Prodhimi i përgjithshëm nga Ekonomia e Ushqimit është rritur me një mesatare prej 5% gjatë periudhës 2010-2019, ndërsa eksportet e sektorit në 2019 përfaqësuan 11,8% të eksporteve totale të vendit, me një rritje të konsiderueshme krahasuar me 8,7% në vitin 2015.

Kontributi i sektorit të Ekonomisë së Ushqimit në vlerën e shtuar bruto të ekonomisë ka qenë i qëndrueshëm ndër vite me një mesatare prej 22% për periudhën 2015-2018. Sektori i bujqësisë ka dhënë gjithashtu kontribut pozitiv në eksportet e vendit gjatë periudhës janar - shtator 2021, megjithë tërmetin e datës 26 nëntor 2019 dhe ndikimit negativ të COVID-19 në ekonominë shqiptare që prej muajit mars 2020.



BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

SEKTORI I BUJQËSISË

Si një nga sektorët prioritar të Ekonomisë së Ushqimit dhe hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor, sektori i bujqësisë karakterizohet nga një strukturë mbjelljesh dhe prodhimitarë ndër vite si në tabelat e mëposhtme:

Tabela Nr. 1. Struktura e mbjelljeve e bimëve të arave vitet 2005 -2020 sip. në 000/ha

| Nr. | Emërtimi | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|----------|-----------------------------|------------|------------|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|------------|--------------|
| 1 | Drithëra | 145.7 | 147.7 | 143 | 142.1 | 143.2 | 142.6 | 148 | 145.7 | 140.1 | 132.2 | 131.3 |
| | Grurë | 73.9 | 69.2 | 73.2 | 71.2 | 70 | 69.6 | 70.5 | 68.1 | 65.1 | 57.3 | 53.9 |
| | Misër | 54.2 | 61.2 | 53.5 | 53.5 | 55 | 54.6 | 58.5 | 58.1 | 54.1 | 55.1 | 56.7 |
| | Thekër | 1.1 | 1.5 | 1.3 | 1.2 | 1.4 | 1.3 | 1.2 | 1.2 | 1 | 1.2 | 1.3 |
| | Elb | 2.5 | 2.8 | 2.4 | 2.5 | 2.7 | 2.5 | 3.1 | 3.1 | 3.4 | 2.7 | 3.8 |
| | Tagjira | 14 | 12.9 | 12.5 | 13.6 | 14.1 | 14.6 | 14.7 | 15.4 | 16.6 | 15.8 | 15.5 |
| 2 | Perime&Bostanore | 30.8 | 30.6 | 31 | 30 | 30 | 31.1 | 31.2 | 31.9 | 31.7 | 33 | 33.5 |
| | Luleshtrydhe | | | | | | | | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 |
| | Patate | 9 | 9.5 | 9.3 | 9.1 | 9.6 | 10.1 | 9.7 | 9.9 | 9.7 | 10.2 | 9.7 |
| | Fasule | 13.7 | 14.4 | 14.6 | 14.2 | 14.6 | 14.9 | 13.7 | 13 | 13.4 | 13.5 | 13.3 |
| | Duhan | 1.2 | 1.2 | 1.3 | 1.7 | 1.5 | 1.2 | 1.1 | 0.9 | 1 | 0.8 | 0.8 |
| | Lule dielli | 1.3 | 1.5 | 1.4 | 0.8 | 0.7 | 0.7 | 0.7 | 0.5 | 0.4 | 0.4 | 0.5 |
| | Sojë | 0.3 | 0.3 | 0.3 | 0.2 | 0.2 | 0.2 | 0.3 | 0.2 | 0.3 | 0.2 | 0.2 |
| | Panxharsheqeri | | | | | | | | 0.7 | 0.7 | 0.8 | 0.8 |
| | Bimë Medicinale/Erëza | | | | | 5 | 5 | 5 | 5.4 | 5.6 | 5.6 | 6.3 |
| | Foragjere të njoma | 202 | 204 | 208.9 | 215.3 | 204.2 | 207.3 | 208.6 | 215.7 | 217.4 | 220.1 | 225 |
| | Sipërfaqja e Mbjellë | 404 | 409 | 409.839 | 413.3 | 408.9 | 413.1 | 418.3 | 424.2 | 420.3 | 417 | 421.6 |

Tabela Nr.2 Prodhimi i bimëve të arave, 2015-2020 (në 000 ton)

| Nr | Emërtimi | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|----------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| 1 | Drithëra | 695.5 | 698.4 | 701.7 | 678.2 | 666.1 | 684.0 |
| | Grurë | 275.0 | 275.0 | 274.9 | 240.3 | 233.2 | 233.4 |
| | Misër | 380.0 | 379.7 | 381.1 | 391.1 | 389.0 | 399.1 |
| | Thekër | 3.0 | 2.7 | 2.7 | 2.3 | 2.6 | 3.2 |
| | Elb | 7.0 | 9.0 | 9.0 | 9.7 | 7.9 | 12.6 |
| | Tagjira | 30.5 | 32.0 | 34.1 | 34.9 | 33.4 | 35.6 |
| 2 | Perime | 1,030.0 | 1,129.0 | 1,152.0 | 1,166.3 | 1,258.0 | 1,295.7 |
| | Luleshtrydhe | | | 5.1 | 4.4 | 5.3 | 5.4 |
| | Patate | 245.0 | 238.3 | 249.8 | 254.5 | 260.7 | 254.9 |
| | Fasule | 28.0 | 24.8 | 21.2 | 24.5 | 24.8 | 25.8 |
| | Duhan | 2.2 | 1.8 | 1.4 | 1.7 | 1.4 | 1.4 |
| | Lule dielli | 2.0 | 2.0 | 1.1 | 0.8 | 1.0 | 1.3 |
| | Sojë | 0.5 | 0.7 | 0.5 | 0.7 | 0.6 | 0.4 |
| | Panxharsheqeri | | | 29.7 | 27.5 | 30.7 | 27.0 |
| | Bimë Medicinale/Erëza | 10.8 | 10.6 | 12.8 | 12.5 | 12.9 | 14.4 |
| | Foragjere të njoma | 6,000.0 | 6,144.0 | 6,688.6 | 7,050.1 | 7,115.2 | 7,170.6 |

Shqipëria ka ende rezerva për shtimin e sipërfaqes së tokës që kultivohet me bimë arash si misër, tagjira, elb, sojë, për të reduktuar importin dhe perime, luleshtry-dhe dhe bimë medicinale për të rritur eksportin.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), ka kryer disa sondazhe nga të cilat rezulton se mund të rritet sasia e tokës që kultivohet edhe me 100 mijë ha të tjerë.

Tabela Nr.3 Sipërfaqe e kultivuar me perime gjithësej, 2014-2020 (në Ha)

| Nr. | Qarku/Prefektura | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|-----|------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| 1 | Berat | 2,406 | 2,481 | 2,689 | 2,789 | 2,824 | 2,969 | 3,098 |
| 2 | Dibër | 1,835 | 1,506 | 1,584 | 1,626 | 1,660 | 1,699 | 1,944 |
| 3 | Durrës | 3,666 | 3,713 | 3,590 | 3,673 | 3,763 | 3,710 | 3,731 |
| 4 | Elbasan | 2,917 | 2,998 | 3,176 | 3,020 | 3,057 | 3,035 | 3,198 |
| 5 | Fier | 8,452 | 8,636 | 9,310 | 9,152 | 9,298 | 10,481 | 10,936 |
| 6 | Gjirokastrë | 916 | 942 | 918 | 900 | 1,095 | 1,154 | 1,136 |
| 7 | Korçë | 2,622 | 2,853 | 2,859 | 2,980 | 3,026 | 3,105 | 3,148 |
| 8 | Kukës | 685 | 662 | 697 | 674 | 705 | 747 | 757 |
| 9 | Lezhë | 1,444 | 1,755 | 1,920 | 2,111 | 2,044 | 2,057 | 2,084 |
| 10 | Shkodër | 3,904 | 3,773 | 3,949 | 4,242 | 3,754 | 3,771 | 3,737 |
| 11 | Tiranë | 5,785 | 5,907 | 6,047 | 6,081 | 6,053 | 6,148 | 6,253 |
| 12 | Vlorë | 1,937 | 1,942 | 2,062 | 2,177 | 2,189 | 2,564 | 2,652 |
| | Shqipëri | 36,569 | 37,168 | 38,801 | 39,425 | 39,468 | 41,440 | 42,674 |

Prodhimi i perimeve në serra dhe në fushë të hapur ka avantazhe shumë të mëdha veçanërisht për rritjen e efikasitetit të përdorimit të tokës bujqësore dhe për rritjen e eksportit.

Kërkesa e konsumatorëve vendas, atyre të vendeve fqinje, europiane e më gjerë për perimet shqiptare ka qenë dhe vazhdon të jetë në rritje.

Kushtet klimatike, toka, uji, eksperiencia shumëvjeçare e fermerëve, janë faktorë pozitiv që duhen vlerësuar më shumë për të rritur sasinë, cilësinë dhe llojshmërinë e perimeve.

Mundësitë për të prodhuar perime në sasi më të mëdha, me cilësi më të mirë, me kosto e çmim konkurrues janë si në serra ashtu dhe në fushë të hapur.



BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

SEKTORI I BUJQËSISË

Tabela nr.4 Prodhimi i perimeve gjithësej, 2014-2020 (në Ton)

| Nr. | Qark/Prefekturë | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|-----|-----------------|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1 | Berat | 90,638 | 105,641 | 120,895 | 121,433 | 118,687 | 126,555 | 131,735 |
| 2 | Dibër | 54,881 | 46,759 | 50,209 | 44,774 | 47,689 | 44,936 | 52,584 |
| 3 | Durrës | 91,955 | 95,260 | 96,928 | 91,224 | 94,544 | 99,221 | 99,896 |
| 4 | Elbasan | 75,261 | 78,683 | 93,015 | 83,949 | 88,216 | 91,806 | 98,176 |
| 5 | Fier | 294,920 | 326,663 | 369,503 | 405,928 | 418,921 | 484,366 | 506,531 |
| 6 | Gjirokastër | 14,230 | 17,294 | 13,713 | 14,098 | 14,495 | 14,810 | 14,851 |
| 7 | Korçë | 68,921 | 78,663 | 81,671 | 85,254 | 81,637 | 82,028 | 76,472 |
| 8 | Kukës | 14,174 | 13,477 | 14,171 | 14,452 | 13,027 | 13,383 | 14,946 |
| 9 | Lezhë | 32,922 | 39,717 | 45,269 | 43,361 | 43,013 | 48,133 | 47,128 |
| 10 | Shkodër | 75,499 | 76,530 | 82,389 | 84,963 | 80,421 | 80,376 | 78,131 |
| 11 | Tiranë | 104,726 | 115,974 | 123,661 | 124,148 | 127,176 | 128,666 | 130,001 |
| 12 | Vlorë | 31,873 | 35,339 | 37,676 | 38,344 | 38,457 | 43,731 | 45,275 |
| | Shqipëri | 950,000 | 1,030,000 | 1,129,100 | 1,151,928 | 1,166,283 | 1,258,011 | 1,295,726 |

Drufrutorët mbas një procesi tranzicioni të gjatë e të vështirë, aktualisht po rriten e zhvillohen me ritme të shpejta në Shqipëri. Prodhimi fidaneve cilësorë dhe të certifikuar në vend mbetet një sfidë që duhet tejkaluar. Mundësitë për investime eficente për një rritje të ndjeshme, si në sasi të numrit të rrënjëve dhe rendimentit për rrënjë nga grupi pemë frutore paraqesin arrorët.

Ulliri, potencialet dhe mundësitë më të mëdha për rritjen e eficencës së investimeve të kryera deri tani i

ka të rritja e rendimentit për rrënjë dhe përmirësimi i cilësisë së vajit.

Agrumet janë në një proces rritje të ndjeshme dhe ka ende rezerva për shtimin e llojshmërisë, numrit të rrënjëve dhe rendimentit për rrënjë.

Vreshtat dhe pjergullat gjithashtu kanë potenciale, rezerva dhe mundësi për të investuar në mbjelljet e reja duke rritur sipërfaqen dhe rendimentin.






Tabela Nr.5 Numri i rrënjëve, prodhimi dhe rendimenti i drufrutorëve, 2010-2020

| Nr | Emërtimi | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|------------|--------------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| I | Pemë Frutore | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej (000 rrënjë) | 10,190 | 11,225 | 11,607 | 11,909 | 12,254 | 12,405 | 12,594 | 13,130 | 13,393 | 13,822 | 14,038 |
| | Në prodhim (000 rrënjë) | 7,439 | 8,313 | 8,992 | 9,292 | 9,654 | 10,185 | 10,575 | 10,961 | 11,120 | 11,579 | 11,767 |
| | Rendimenti (kg/rrënjë) | 22.6 | 22.6 | 23.4 | 23.5 | 22.8 | 24 | 25 | 24 | 25 | 24 | 23 |
| | Prodhim (000 ton) | 167.8 | 188.1 | 210 | 218 | 220 | 245 | 261 | 263 | 274 | 274 | 274 |
| II | Ullinj | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej (000 rrënjë) | 6,255 | 7,443 | 8,000 | 8,620 | 8,994 | 9,225 | 9,608 | 9,786 | 10,008 | 10,288 | 10,532 |
| | Në prodhim (000 rrënjë) | 4,298 | 4,576 | 4,829 | 5,277 | 5,803 | 6,332 | 6,643 | 7,442 | 7,798 | 8,226 | 8,616 |
| | Rendimenti (kg/rrënjë) | 16.3 | 14.3 | 22 | 14.7 | 16.9 | 12 | 15 | 14 | 15 | 12 | 15 |
| | Prodhim (000 ton) | 70 | 65.4 | 108 | 92 | 98 | 96 | 99 | 108 | 118 | 98 | 132 |
| III | Agrume | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej (000 rrënjë) | 763 | 916 | 1,010 | 1,125 | 1,200 | 1,282 | 1,354 | 1,394 | 1,454 | 1,521 | 1,589 |
| | Në prodhim (000 rrënjë) | 530 | 589 | 633 | 767 | 859 | 951 | 1,044 | 1,109 | 1,154 | 1,265 | 1,329 |
| | Rendimenti (kg/rrënjë) | 25.2 | 25.5 | 29.8 | 26.1 | 24.4 | 32 | 38 | 37 | 39 | 37 | 37 |
| | Prodhim (000 ton) | 13.4 | 15 | 18.9 | 20 | 21 | 30 | 40 | 41 | 45 | 47 | 49 |
| IV | Pjergulla | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej (000 rrënjë) | 5,501 | 5,743 | 5,859 | 5,974 | 6,075 | 6,109 | 6,197 | 6,173 | 6,280 | 6,434 | 6,545 |
| | Në prodhim (000 rrënjë) | 5,100 | 5,208 | 5,380 | 5,494 | 5,599 | 5,655 | 5,775 | 5,828 | 5,872 | 6,008 | 6,103 |
| | Rendimenti (kg/rrënjë) | 16.2 | 16 | 15.2 | 15.4 | 15 | 15 | 14 | 14 | 13 | 13 | 13 |
| V | Vreshta | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej (000 rrënjë) | 9,712 | 10,073 | 10,136 | 10,178 | 10,383 | 10,438 | 10,533 | 10,695 | 10,878 | 10,842 | 12,002 |
| | Në prodhim (000 rrënjë) | 8,630 | 9,077 | 9,348 | 9,579 | 9,625 | 9,891 | 10,011 | 10,057 | 10,179 | 10,255 | 10,445 |
| | Rendimenti (kg/rrënjë) | 118.6 | 123.4 | 123.1 | 124.5 | 12.4 | 124 | 124 | 122 | 108 | 111 | 114 |
| | Rush gjithsej (ton 000) | 184.9 | 195.2 | 196.8 | 240.0 | 203.7 | 205.0 | 205.1 | 202.9 | 184.8 | 189.9 | 199.1 |

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

MEKANIZIMI, INOVACIONI DHE DIGJITALIZIMI NË SEKTORIN E BUJQËSISË

Shqipëria aktualisht nuk ka ende një nivel të përparuar për mekanizimin, inovacionin dhe digjitalizimin e sektorit të bujqësisë, dhe të hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor. Numri i traktorëve bujqësor në përdorim është rreth 10 mijë nga 15 mijë që i nevojiten gjithësej për të përballuar periudhat kulmore të punimeve. Traktorët janë të prodhuar më shumë se 20 vite më parë, me një teknologji të vjetër, shumë marka traktorësh aktualisht nuk prodhohen dhe nuk gjenden më pjesë këmbimi në treg. Nga numri i traktorëve në punë vetëm 2000 traktorë plotësojnë kriteret e BE-së për t'u shfrytëzuar me efikasitet në punimet bujqësore. 54 % e familjeve fermere përdorin mjetet e mekanizuara për punimin e tokës, për kultivimin dhe vjeljen e bimëve, 46 % për punimet në bujqësi përdorin krahët dhe kafshët e punës.



Shqipëria përdor me efikasitet mesatarisht 1.24 traktorë për 100 ha tokë të punuar. Ndërsa Maqedonia e Veriut 6 traktorë, Greqia 6.6 traktorë, Italia 13.2 traktorë, shtetet e Bashkimit Evropian 8.1 traktorë për 100 ha tokë.

Gjithashtu, Shqipëria në procesin e punimit të tokës, vjeljes dhe kultivimit të bimëve përdor 1.5 - 2 makineri bujqësore për traktor, vendet e rajonit jo pjesë e BE përdorin mesatarisht 5 - 7 te tilla, ndërsa vendet e Bashkimit Evropian 13 makineri bujqësore për traktor.



Plotësimi dhe rinovimi i parkut të traktorëve bujqësorë dhe makinerive për kultivimin dhe në veçanti për vjeljen e prodhimit mbetet një sfidë, që sektori publik, ai privat dhe asistencë nga donatorët, po punojnë për zgjidhjen e saj sa më shpejt. Hapi i parë me rëndësi në këtë drejtim nga qeveria është hedhur duke reduktuar me mbi 50% çmimin e karburantit që përdoret për punimet kryesore në bujqësi.



Inovacioni dhe digjitalizimi janë në hapat e para të përdorimit dhe duhet theksuar se në këtë drejtim në bujqësi po ecet me ritme të shpejta. Shqipëria ka një kuadër ligjor bashkëkohor në mbështetje të inovacionit dhe digjitalizimit të sektorit të bujqësisë dhe të gjitha hallkave kryesore të zinxhirit në fushën e Ekonomisë së Ushqimit.

BLEGTORIA

Blegtoria në Shqipëri është një tjetër hallkë me shumë rëndësi, mbas bujqësisë, në fushën e Ekonomisë së Ushqimit. Në sektorin e blegtorisë ushtrojnë veprimtarinë e tyre 292 mijë ferma dhe fermerë të organizuara në mënyrë individuale, në ferma të vogla dhe të mesme si dhe në Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), të shpërndara në rreth 2500 fshatra, në të gjithë territorin e vendit.

Në këtë sektor ushtrojnë veprimtarinë e tyre Shoqatat anëtare të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar “KASH” si: Shoqata Bashkimi Kombëtar i Fermerëve Shqiptar “BKFSH”, Shoqata e Blegtorëve Shqiptar “LEAA”, Shoqata Shëndeti i Kafshëve dhe Mjedisit, Shoqata e Prodhuesve dhe Përpunuesve të Qumështit dhe Mishit “ADAMA”, SHBB “Stacionet Veterinare Private të Shqipërisë”. “Shoqata e thertoreve”.

Gjithashtu funksionon prej disa vitesh “Urdhëri Profesional i Mjekëve Veterinerë”. Këto janë aktualisht institucionet private më të rëndësishme, që asistojnë fermerët në sektorin e blegtorisë.



Komuniteti i blegtorëve është një nga komunitetet e mëdha prodhuese në vend pasuria e të cilit vlerësohet mbi 1.8 miliard euro. Formalizimi i sektorit mbetet një sfidë për t'u tejkaluar. Mbi 80 % e komunitetit të blegtorëve janë aktualisht të pa formalizuar.

Fermerët e pa formalizuar që nuk kanë dokumentin e identifikimit NIPT, shumica nuk mundin të shesin tepricën e produkteve drejtpërdrejt në njësi shitje ose tregjet me standarde.

Nuk mund të përfitojnë drejtpërdrejt grante dhe as kredi me kushte lehtësuese. Nuk mund të marrin lehtësisht leje ndërtimi që të kryejnë investime afatgjata, veçanërisht ato në bashkëpunim me partnerë të huaj.

Formalizimi i këtij sektori është një nga sfidat e rradhës, që po punohet për ta futur në rrugën e zgjidhjes, me synim për t'i hapur rrugë edhe eksportit të kafshëve të gjalla dhe produkteve blegtorale.

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

BLEGTORIA

Tabela 6. Numri krerëve të bagëtive 000/krerë periudha 2013 -2020

| Lloji | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Gjedhë | 498 | 500 | 506 | 492 | 475 | 467 | 416 | 363 |
| Lopë | 356 | 358 | 362 | 355 | 349 | 343 | 316 | 289 |
| Të imta,dele,dhi | 2,736 | 2,800 | 2,851 | 2,913 | 2,859 | 2,781 | 2,621 | 2,332 |
| Të leshta | 1,866 | 1,896 | 1,918 | 1,972 | 1,926 | 1,864 | 1,758 | 1,558 |
| Dele | 1,414 | 1,419 | 1,426 | 1,428 | 1,407 | 1,366 | 1,297 | 1,174 |
| Të dhirta | 869 | 904 | 932 | 941 | 933 | 917 | 863 | 774 |
| Dhi | 657 | 695 | 712 | 716 | 717 | 699 | 671 | 619 |
| Derra | 152 | 172 | 177 | 181 | 180 | 184 | 184 | 158 |
| Dosa | 12 | 11 | 12 | 13 | 12 | 12 | 14 | 13 |
| Njëthundrakë | 93 | 91 | 91 | 95 | 89 | 88 | 87 | 79 |
| Shpendë total | 8,907 | 9,493 | 8,558 | 8,326 | 7,835 | 8,362 | 8,179 | 7,907 |
| Pula | 5,965 | 6,645 | 5,324 | 4,790 | 4,820 | 4,963 | 5,004 | 5,001 |
| Bletë (koshere) | 246 | 287 | 271 | 303 | 290 | 285 | 288 | 358 |

Tabela 7. Prodhimet blegtorale 000/ton periudha 2013 -2020

| Lloji | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Qumësht gjithsej | 1,131,156 | 1,133,001 | 1,131,209 | 1,145,097 | 1,156,286 | 1,144,353 | 1,112,196 | 1,052,192 |
| Qumësht Lope | 969,151 | 965,001 | 964,106 | 974,663 | 982,510 | 273,526 | 946,561 | 897,349 |
| Qumësht Dele | 84,000 | 89,000 | 87,102 | 85,446 | 86,927 | 84,788 | 81,669 | 74,649 |
| Qumësht Dhie | 78,005 | 79,000 | 80,001 | 84,988 | 86,849 | 86,040 | 83,966 | 80,194 |
| Mish gjithsej | 153,169 | 155,001 | 158,038 | 159,818 | 161,286 | 161,373 | 156,898 | 150,354 |
| Mish Gjedhi | 69,701 | 70,500 | 71,400 | 72,137 | 72,253 | 68,829 | 66,117 | 62,339 |
| Mish të lmtash | 48,969 | 49,500 | 52,538 | 50,627 | 52,014 | 55,901 | 54,096 | 51,648 |
| Mish Derri | 17,360 | 17,501 | 16,799 | 17,331 | 17,001 | 16,913 | 16,406 | 15,318 |
| Mish Shpendi | 17,140 | 17,500 | 17,300 | 19,724 | 20,018 | 19,731 | 20,025 | 21,049 |
| Vezë | 830,000 | 835,224 | 830,000 | 830,000 | 811,088 | 827,508 | 864,510 | 861,018 |
| Lesh | 3,083 | 3,110 | 3,332 | 3,431 | 3,123 | 3,331 | 3,182 | 2,831 |
| Mjaltë | 3,016 | 3,150 | 3,200 | 3,923 | 3,614 | 3,937 | 4,116 | 4,599 |

PESHKIMI DHE AKUAKULTURA

Rezervat ujrore në Shqipëri janë shtëpia e 110 familjeve me 260 lloje të peshqve që rriten kryesisht në Detin Mesdhe. Peshkimi në Shqipëri është një aktivitet që zhvillohet si në ujrat e brendshme, në lumenj, laguna, dhe në det. Aktiviteti i peshkimit detar shtrihet në të gjithë vijën bregdetare, përfshirë ujrat territoriale të saj dhe 12 milje nga vija bregdetare bazë.

Shqipëria, fal rezervave ujrore, ekosistemit dhe biodiversitetit, përveç peshkimit komercial dhe ekzistencial, ka akoma potenciale të mëdha për t'i përdorur në drejtim të ushtrimit të peshkimit rekreativ (sportiv). Peshkimi i troftës në veri të Shqipërisë në lumin e Valbonës, Cemit dhe Shalës, në Shqipërinë e mesme lumi Shkumbin veçanërisht në zonën e Librazhdit. Në jug Lumi Vjosa është lumi i vetëm në rajon dhe më gjerë që deri tani nuk i është bërë asnjë dëm i riparueshëm dhe mund të zhvillohet me ritme të shpejta peshkimi dhe sportet rekreative në të gjitha format e tyre.

Midhja që rritet në Liqenin e Butrintit është mjaft cilësore dhe është ndër speciet e rralla në rajon që i ka mbijetuar evolucionit. Cilësia dhe rendimenti i midhjes së prodhuar në Liqenin e Butrintit është shumë e mirë. Aktualisht prodhohet rreth 1000 ton/vit, por mundësitë janë për t'u rritur sasia e prodhimit në 5000 ton/vit brenda një periudhe të shkurtër kohe. Kapaciteti prodhues i midhjeve në Liqenin e Butrintit është llogaritur në 9000 ton/vit.



BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

PESHKIMI DHE AKUAKULTURA

Tabela Nr. 8 Zënie peshku sipas kategorive ujore 2016 -2020

| Sasia | | | | | |
|--------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| I+II Gjithsej zënie | 12,534.0 | 12,719.0 | 14,875.0 | 15,010.6 | 16,892.0 |
| I Gjithsej | 7,884.0 | 8,289.0 | 8,629.0 | 8,706.7 | 7,808.0 |
| I.1 Detar | 4,646.0 | 4,609.0 | 5,537.0 | 5,499.3 | 4,521.0 |
| I.2 Bregdeti | 952.0 | 1,074.0 | 315.0 | 342.3 | 364.9 |
| I.3 Laguna | 598.0 | 599.0 | 350.0 | 93.5 | 78.9 |
| I.4 Ujrat e brëndshme | 1,688.0 | 2,007.0 | 2,427.0 | 2,771.6 | 2,843.7 |
| II Gjithsej akuakultura | 4,650.0 | 4,430.0 | 6,246.0 | 6,303.9 | 9,084.0 |
| II.1 Akuakulturë | 3,200.0 | 4,000.0 | 5,138.0 | 5,228.9 | 8,798.9 |
| II.2 Molusqe | 1,450.0 | 430.0 | 1,108.0 | 1,075.0 | 285.1 |

Tabela Nr. 9 flota detare sipas llojit të anijes 2016 – 2020

| Lloji i Anijes | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Me tërheqje (fundore dhe pelagjike) | 156 | 157 | 170 | 180 | 191 |
| Me mrezha | | 5 | 4 | 9 | 0 |
| Me koshilok | 8 | 8 | 7 | 3 | 9 |
| Me draga hidraulike | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Me njica | 368 | 360 | 424 | 434 | 495 |
| Anije shumëpërdorimshme | 25 | 24 | 22 | 20 | 20 |
| Total | 565 | 559 | 632 | 651 | 720 |

AGROBIZNESI

Agrobiznesit në Shqipëri për rëndësinë e madhe që ka për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe të gjitha hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor vitet e fundit i është kushtuar një rëndësi e madhe për investime si nga sektori publik dhe nga sektori privat veçanërisht qendrave të grumbullimit.

Qendrat e grumbullimit, standartizimit, ambalazhimit, paketimit, ruajtjes në kushte të përshtatshme dhe tregëtimit me destinacion tregun vendas dhe për eksport janë shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Numri dhe investimet në këto qendra që shërbejnë për të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor janë rritur ndjeshëm.



Tabela Nr.10 Qendra të grumbullimit të produkteve në shkallë vendi sipas rajoneve

| Nr. | Qendra të grumbullimit të produkteve | Nr. | Nr. | Sipas rajoneve | Nr. |
|-----|--------------------------------------|------------|-----|----------------|------------|
| 1 | Për Fruta dhe Perime | 175 | 1 | Lushnjë | 90 |
| 2 | Për Bimë Medicinale | 42 | 2 | Korçë | 73 |
| 3 | Të tjera | 10 | 3 | Tiranë | 43 |
| | TOTALI | 227 | 4 | Shkodër | 21 |
| | | | | TOTALI | 227 |

Qendrat e grumbullimit aktualisht bashkëpunojnë në formë klasteri me mbi 42 mijë fermerë prodhues, duke i asistuar për programin dhe llojshmërinë e mb-

jelljeve, duke i furnizuar me inputet e nevojshme që duhen përdorur, duke ua marr prodhimin e kërkuar si nga tregu vendas dhe ai për eksport.

Tabela Nr. 11 Të dhëna për tregjet e shumicës sipas qarqeve

| Nr | Prefektura/Rrethi | Lloji i Qendrave të Grumbullimit | | | TOTALI |
|----|----------------------|----------------------------------|-----------------|----------|------------|
| | | Fruta /Perime | Bimë Medicinale | Të tjera | |
| 1 | Lushnjë/Fier | 24 | | | 24 |
| 2 | Divjakë/Fier | 15 | 1 | | 16 |
| 3 | Fier | 8 | | | 8 |
| 4 | Patos/Fier | 1 | | | 1 |
| 5 | Roskovec/Fier | 11 | | | 11 |
| 6 | Vlorë | 6 | 3 | 1 | 10 |
| 7 | Gjirokastër | 1 | | | 1 |
| 8 | Dropull/Gjirokastër | | 2 | 2 | 4 |
| 9 | Libohovë/Gjirokastër | | 1 | | 1 |
| 10 | Memaliaj/Gjirokastër | 1 | | 2 | 3 |
| 11 | Tepelene/Gjirokastër | | 1 | | 1 |
| 12 | Përmet/Gjirokastër | 1 | 3 | 1 | 4 |
| 13 | Këlcyrë/Gjirokastër | 3 | | | 3 |
| 14 | Berat | 1 | | 1 | 2 |
| 15 | UraVajgurore/Berat | 13 | | | 13 |
| 16 | Korçë | 29 | | | 29 |
| 17 | Devoll/Korçë | 18 | | 1 | 19 |
| 18 | Pogradec/Korçë | 1 | | | 1 |
| 19 | Elbasan | 5 | 2 | 1 | 8 |
| 20 | Cërrik/Elbasan | | | 1 | 1 |
| 21 | Peqin/Elbasan | 1 | | | 1 |
| 22 | M. e Madhe/Shkodër | | 5 | 1 | 6 |
| 23 | Shkodër | 1 | | | 1 |
| 24 | Lezhë | | 2 | 2 | 4 |
| 25 | Kurbini/Lezhë | | 2 | | 2 |
| 26 | Mirditë/Lezhë | | | 1 | 1 |
| 27 | Kukës | 1 | 2 | 1 | 4 |
| 28 | Tropojë/Kukës | 2 | 1 | | 3 |
| 29 | Peshkopi/Dibër | 8 | | 2 | 10 |
| 30 | Bulqizë/Dibër | 2 | | | 2 |
| 31 | Durrës | 1 | 7 | 6 | 14 |
| 32 | Shijak/Durrës | 2 | 1 | 1 | 4 |
| 33 | Krujë/Durrës | 1 | 2 | | 3 |
| 34 | Tiranë | | 6 | | 6 |
| 35 | Rrogoshinë/Tiranë | 1 | | 1 | 2 |
| 36 | Kavajë/Tiranë | | | 2 | 2 |
| 37 | Kamëz/Tiranë | | 1 | | 1 |
| | TOTALI | | | | 227 |

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

AGROPËRPUNIMI

Industria agro-përpunuese në Shqipëri është në zhvillim dhe konsiderohet se ka potenciale të qenësishme për investime, veçanërisht për perimet, frutat dhe Bimët Mjekësore Aromatike (BMA). Ndër produktet e zgjedhura, gështenjat, domatet dhe BMA-të konsiderohen si tre produktet kryesore që kanë më shumë potencial për agropërpunim.

Prodhuesit primar të lëndëve të para aktualisht po bashkëpunojnë me kompanitë agropërpunuese, për t'u dhënë zgjidhje disa problemeve që lidhen kryesisht me: Kostot e larta të lëndëve të para vendase, mungesa e likuiditetit, standardet dhe cilësia, fragmentimi dhe mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit. Ndërsa në lidhje me përpunimin dhe marketingun e produkteve problematike është informaliteti në tregun e brendshëm. Përsa i përket “Menaxhimit të Biznesit” në këtë hallkë të zinxhirit ushqimor, problemet kryesore lidhen me gjetjen e punonjësve të specializuar dhe qasja në financim. Gjithashtu, mungesa e certifikatave të pronës dhe pasiguria e lartë në lidhje me pronësinë e tokës ka penguar e ndaluar disa nga kompanitë e agropërpunimit, që të investojnë dhe zgjerohen. Kjo përbën një pengesë të rëndësishme edhe për aplikimet në grantet IPARD, kreditë bankare dhe lejët zhvillimore.



Përpunimi i frutave. Industria e përpunimit të lëngjeve kërkon investime në linja moderne (pasterizim të lëngjeve dhe paketim Tetra pack) për përpunimin e frutave. Kjo industri duhet të mundësojë prodhimin e koncentreve të frutave për eksport. Kjo industri është fokusuar dhe synon të përfshijë gjithashtu përpunimin e frutave të pyjeve (boronica, manaferra, dëllena e zezë, mjedra, etj.) aty ku edhe kërkesa e tre-

gut të vendit dhe atij për eksport po rritet.

Përpunimi i domates. Industria e përpunimit të salcës kërkon shtim të investimeve në teknologjitë bashkëkohore të përpunimit për prodhimin e formave të ndryshme të salcave ashtu si kërkohe në tregun botëror. Ndërkohë, zhvillimi i këtij nën-sektori do të plotësojë kërkesën e tregut të brendshëm duke ulur ndjeshëm vëllimet e mëdha të importit.



Përpunimi i gështenjës. Proceset e përpunimit të gështenjës shihen si një domosdoshmëri në rritjen e vlerës së këtij produkti. Investimet në procesin e përpunimit të plotë të gështenjave, d.m.th tharrja dhe zhveshja e plotë, si dhe përpunimi i miellit për industrinë e ëmbëlsirave, janë nevojat të menjëhershme në këtë sektor.

Përpunimi i bimëve mjekësore aromatike (BMA). Pavarësisht faktit që ky sektor ka patur arritje në këto vite, ekziston ende një mundësi për të rritur akoma më shumë volumin e produkteve të përpunuara, d.m.th përpunimin e disa bimëve mjekësore të kërkuara nga industria farmaceutike, pra prodhimin e esencave. Kjo kërkon investime në distileri moderne për prodhimin e esencave. Prodhimi i esencave do të jetë një mundësi e mirë edhe për zhvillimin e industrisë farmaceutike shqiptare.

BUJQËSIA DHE HALLKAT KRYESORE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

BIMËT MJEKËSORE, AROMATIKE DHE BLETARIA

Fermerët në Shqipëri aktualisht kultivojnë, grumbullojnë dhe eksportojnë 186 lloje me bimë mjekësore dhe aromatike nga 330 specie bimë mjekësore dhe aromatike gjithësej që rriten në Shqipëri.

Spektori punëson mbi 90 mijë punonjës, 4 mijë prej të cilëve merren edhe me kultivimin e bimëve në një sipërfaqe me mbi 1000 ha.

Spektori BMA pavarësisht nga tërmeti dhe pandemia COVID-19, në vitin 2020 u rrit me 16.5 % dhe 31 kompanitë eksportuese kanë realizuar një sasi valute në eksport prej 57 milion euro. SHBA importon nga Shqipëria $\frac{3}{4}$ e sasisë së Sherebelës që konsumon.

Arritjet pozitive të sektorit BMA mbështeten kryesisht në përvojën e gjatë të punës, eksperiencën në grumbullim, kultivim dhe eksportin e BMA-ve, tokën dhe kushtet klimatike të përshtatshme, reputacionin e mirë të fituar nga operatorët e sektorit për cilësinë e lartë të bimëve të egra, disponueshmëria e krahut të punës për vjelje dhe kultivim të BMA-ve,

investimet e bëra në ambientet e ruajtjes dhe të tharjes së BMA-ve, për përpunimin dhe përgatitjen e tyre për t'u përdorur si çaj në tregun vendas dhe në eksport.

Spektori BMA me gjithë arritjet, ka akoma nevojë për mbështetje dhe investime sepse ka rezerva dhe potenciale të pa përdorura për t'u rritur dhe zgjeruar investimet. Mbështetja dhe investimet në këtë sektor do të nevojiteshin për mbjelljet e reja të BMA-ve, makineri bujqësore (traktorë, makineri për vjelje, nivelimin e dheut), mjedise për tharrje, linja të thjeshta përpunimi me synim zgjerimin dhe modernizimin e procesit hap pas hapi deri në distilim, rafinim e sterilizim të vajit esencial, magazinimin e BMA-ve, prodhimin e çajrave të llojeve të ndryshme për tregun vendas dhe për eksport.



SEKTORI I BLETARISË

Bleta konsiderohet si një indikator real për vlerësimin e nivelit të pastërtisë së ambientit, të nivelit të përdorimit të insekticideve, pesticideve, plehrave kimikë, si dhe kontribuese kryesore për rritjen e nivelit të pjalmimit në sektorin e bujqësisë. Studime të ndryshme kanë arritur në përfundim se 1/3 e bimësisë në botë pllenohet nga bletët. Në këtë këndvështrim Albert Ajnshtajni ka thënë: "Nëse bletët zhduken, jo më shumë se 4 vite më vonë do të zhduket edhe njerzimi". Shqipëria ka kushte klimaterike të favorshme, pyje, kullota, livadhe me një shumëllojshmëri specie bimësh mjaltëdhënëse, që përbëjnë një mundësi reale, për rritjen e numrit të koshereve të bletëve dhe prodhimin sasior e cilësor të mjaltit dhe disa produkte të tjera, që realizohen nga bletaria si propolis, dylli bletës, poleni dhe qumështi i bletës. Kostoja për hapjen e një biznesi në Shqipëri për rritjen e bletëve nuk është e lartë. Tregu i vendit

dhe ai i eksportit kanë kërkesa në rritje për mjalt dhe produkte të tjera nga bletët.

Shqipëria konsumon mjalt rreth 1 kg/frymë në vit ndërsa vendet e rajonit 2-3 kg/frymë. Biznesi nga bletët paraqet një mundësi fitimprurëse për t'u shfrytëzuar nga familjet fermere për të reduktuar varfërinë dhe sipërmarrësit për të shtuar të ardhurat dhe fitimet e tyre. Prodhimi i mjaltit ka ardhur në rritje vit mbas viti. Shqipëria në vitin 2020 arriti të prodhojë 4599 ton mjalt, nga një numër prej 383 250 koshere me një rendiment mesatar 12 kg /koshere. Greqia ka arritur të marrë deri në 30 kg mjalt/koshere, Turqia deri në 50 kg /koshere. Shifra të cilat tregojnë edhe për rezervën e madhe që ka Shqipëria, për rritjen e prodhimin të mjaltit, si nga rritja e numrit të koshereve dhe nga rritja e rendimentit për koshere.

AGROTURIZMI, AGROPYLLTARI DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE

Shqipëria ofron një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit. Ndërsa ky sektor është shfaqur të zhvillohet vetëm gjatë viteve të fundit, pritet që ai të rritet shpejt në të ardhmen e afërt dhe të mesme.

Agroturizmi është një aktivitet prites që zhvillohet në fermë ose në njësi të tjera bujqësore me qëllim tërheqjen e vizitorëve, shpesh duke u mundësuar që të marrin pjesë në aktivitete bujqësore ose aktivitete të tjera ndihmëse që zhvillohen në mjedisin bujqësor.

Çdo formë e turizmit që tregon jetën rurale, artin, kulturën dhe trashëgiminë në vendet rurale, i sjell komunitetit vendas përfitime ekonomike dhe sociale, si dhe që mundëson ndërveprimin midis turistëve dhe banorëve vendas për një përvojë më të pasur turistike, mund të përkufizohet si turizëm rural.

Agroturizmi është një nëndegë e turizmit rural, me një koncept më të gjerë që mund të përfshijë pothuajse çdo veprimtari turistike që zhvillohet në vendet rurale.



Potenciali i pashfrytëzuar për zhvillimin e agroturizmit ekziston pothuajse në të gjithë vendin. Qarqet që paraqesin më tepër potencial në ndërthurjen e bujqësisë me atraksionet turistike janë Korça, Berati, Gjirokastra, Vlora, Shkodra, Kukësi dhe Dibra. Modelet më të zakonshme të agroturizmit janë restorantet “nga ferma në tryezë” me kapacitete të kufizuara akomodimi. Agroturizmi trajtohet si një sektor me prioritet të lartë në programin e qeverisë. Shumica e strategjive të nivelit qendror dhe vendor e kanë konsideruar agroturizmin të rëndësishëm për bujqësinë dhe diversifikimin rural. Sektori po përfiton nga disa stimuj

fiskalë që përfshijnë reduktim të tvsh-së në 6%, tatim mbi të ardhurat e shoqërisë në 5% dhe përjashtim nga taksa e infrastrukturës për investimet. Programi “100 fshatrat” dhe programe të tjera mbështetëse, pritet të sjellin një vlerë prej 50- 70 milionë euro investime të reja në sektor gjatë 5-7 viteve të ardhshme. Gjithashtu, pritet të rrisë ofertën me 27 njësi të reja të agroturizmit dhe rreth 150 bujtina.

Në secilin qark ka rreth 500 ferma të regjistruara që përshtaten me karakteristikat e agroturizmit dhe rreth 20% e tyre janë të gatshme të fillojnë një biznes agroturizmi. Ekzistenca e 12 rrethëve do të thotë 1200 sipërmarrje potenciale agroturizmi që presin mundësi investimi gjatë 5 deri në 7 vitet e ardhshme.



VKM nr. 22, datë 12.01.2018 përcakton kriteret minimale që duhen përmbushur në mënyrë që një njësi të klasifikohet si njësi agroturizmi. Kriteret lidhen me sipërfaqen minimale të tokës bujqësore, kapacitetet akomoduese dhe shërbyese të ushqimit, burimet e produkteve etj. Më konkretisht, kriteret janë:

- Toka - 1 ha në terren të hapur ose 0,5 ha në zona të mbrojtura;
- Shërbimet - Njësitë e agroturizmit duhet të ofrojnë një nga shërbimet e mëposhtme: ushqim, akomodim, shërbime rekreative;
- Kapacitetet e akomodimit: - 6 deri 30 dhoma akomodimi.
- Arkitektura e ndërtesave: Në përputhje me VKM-të nr. 711 dhe 730 për “Kushtet, kriteret dhe procedurat për klasifikimin e strukturave akomoduese”.
- Restorantet - nga 6 deri në 60 tavolina për shërbimin e ushqimit;
- Origjina e produkteve - të paktën 30% e ushqimeve dhe pijeve që ofrohen në njësitë e agroturizmit duhet të jenë prodhime të fermës, pjesa tjetër prej 70% mund të blihet nga fermat e tjera përreth. Pra, agroturizmi nuk mund të shihet si i ndarë nga veprimtari të bujqësore.

Tabela Nr. 12 subjektet e lincesuara të Agroturizmit

| Nr | Emri i Kompanisë | Telefon | E-mail | Adresa | Kapacitetet akomoduese |
|----|-------------------------------|-------------|--|-------------------------|---------------------------|
| 1 | Alfred Fiska <u>P.F</u> | 06820 91617 | alpetwineri@gmail.com | Roshnik/Berat | 8 |
| 2 | Albina Çuko <u>P.F</u> | 0692105543 | albinaçuko1@gmail.com | Shën-Gjergj/Tiranë | 6 |
| 3 | Qafshamë Sh.p.k | | info@shkreliresort.al | Qafshamë/Krujë | 25 |
| 4 | Kol Marku <u>P.F</u> | 0684652952 | ari-al85@hotmail.com | Katund i vjetër/Mirditë | 6 |
| 5 | Qemal Alushi <u>P.F</u> | 0682036634 | alushiolsi87@gmail.com | Prezë/Tiranë | 6 |
| 6 | Shqipe Huqi <u>P.F</u> | 0694099909 | agroturizmi.huqi@gmail.com | Radë/Durrës | 6 |
| 7 | Libonike Nurellari <u>P.F</u> | 0695262940 | fatosnurellari@yahoo.com | Peshtan/Polican | 6 |
| 8 | Agro Gjepali Sh.p.k | 0684370437 | fundingjepali@gmail.com | Gjepalaj/Shijak | 6 |
| 9 | Altin Prenga <u>P.F</u> | 0696555252 | altinprenga@yahoo.it | Fishtë/Lezhë | 9 |
| 10 | Kodra e Kaujve Sh.p.k | 0696090081 | kodra_kaujve@yahoo.com | Kodra e Dedejve Durrës | 18 |
| 11 | Gramozi Br Sh.p.k | 0682297081 | gramozibr@gmail.com | Poshnjë/Berat | 7 |
| 12 | Our Own Expedition | 0676096010 | nancytare@ourownexpedition.com | Nivicë/Tepelenë | 6 |
| 13 | Jeton Hida <u>P.F</u> | 0693054121 | farmasotira@gmail.com | Ersekë/Korçë | 7 |

AGROPYLLTARIA DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE

Agropylltaria është një praktikë pak e dëgjuar dhe e zhvilluar, por ajo ofron potenciale e mundësi të mira përfitimi për fermerët në Shqipëri. Ajo shërben si habitat për botën e egër shtatzore, për rritjen e cilësisë së ujit dhe ajrit, duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e mikroklimës së zonës, rrit të ardhurat e diversifikuara të fermës, përmirëson shëndetin në komunitetet rurale, ndikon në rritjen e rendimentit dhe prodhimit bimor nga 7-35 %, rrit numrin e produkteve dhe të ardhurave nga ferma, përmirëson cilësinë e tokës dhe redukton erozionin, redukton inputet që përdoren për menaxhimin e dëmtuesve, humusi pyllit shërben si një burim i rëndësishëm dhe lëndë e parë për prodhimin e plehut organik ekologjik.

Përmirësimi i mjedisit në zonat rurale në Shqipëri ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), shoqatave të prodhuesve të produkteve organike, për të marrë disa masa pa humbur kohë, për mirë menaxhimin e mbetjeve organike, riciklimi i tyre dhe përdorimi për prodhimin e plehut organik ekologjik është një mundësi e mirë për investime në këtë fushë. Sipas një studimi që është bërë nga ekspertë të fushës rezulton se në Shqipëri dekompozohen në natyrë pa u përpunuar rreth 1 milion ton në vit mbetje organike. Vlerësohet se një pjesë e mirë e tyre mund të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e plehut organik ekologjik. Aktualisht me dhjetra mijë ton në vit pleh organik importohen nga subjektet shqiptare.

TREGJET AGRO BLEGTORALE

Tregjet Agro blegtorale janë nje lidhëse mjaft të rëndësishme midis prodhuesit dhe konsumatorit.

| Nr | Rrethi | Vendodhja e Tregut | Dita e Aktivitetit | | | | | | |
|----|--------------|--------------------|--------------------|---------|-----------|---------|----------|----------|--------|
| | | | E Henë | E Martë | E Merkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë | E Diel |
| 1 | Berat | Poshnjë | | + | | | | | |
| 2 | Kucovë | | | | | | | | |
| 3 | Skrapar | Skrapar | | | | | | + | |
| 6 | Bulqizë | Shupenzë | | | | | | | + |
| 7 | Dibër | Peshkopi | | | | | | | + |
| 8 | Mat | Klos | | | | | | | + |
| 9 | Durrës | Shijak | | | | | | | + |
| 10 | Krujë | Nikel | | | + | | | + | |
| 11 | Elbasan | Mengel | | | | | | | + |
| | | Belsh | | | | | | + | |
| | | Mollas | | | | + | | | |
| 12 | Gramsh | Cekrez | | | | | | + | |
| 13 | Librazhd | Librazhd | | | | | | + | |
| | | Qukës | | | | + | | | |
| | | Hotolisht | | | + | | | | |
| | | Përrenjas | | | | | | + | |
| 14 | Peqin | Pajovë | | | + | | | | |
| 15 | Fier | Fier | | | | | | + | |
| 16 | Mallakastër | Fratar | | | | | | | |
| 17 | Lushnjë | Bubullimë | | | | | + | | |
| | | Zhyma | | | + | | | | |
| | | Krutje | | | + | | | | |
| 18 | Gjirokastrë | | | | | | | | |
| 19 | Përmet | Ballaban | | | | + | | | |
| 20 | Tepelenë | | | | | | | | |
| 21 | Devoll | | | | | | | | |
| 22 | Kolonjë | Ersekë | | | | + | | | |
| 23 | Korçë | Voskop | | | | | | | + |
| 24 | Pogradec | Ceravë | | | | + | | | |
| | | Proibisht | | | | | | + | |
| 25 | Has | | | | | | | | |
| 26 | Kukës | Kukës | | | | | | | + |
| 27 | Tropojë | | | | | | | | |
| 28 | Kurbin | Milot | | | | | | | + |
| 29 | Lezhë | | | | | | | | |
| 30 | Mirditë | | | | | | | | |
| 31 | M. e Madhe | | | | | | | | |
| 32 | Pukë | | | | | | | | |
| 33 | Shkodër | Shkodër | | | | | | | + |
| | | Vau i Dejës | | | | | | + | |
| 34 | Kavajë | | | | | | | | |
| 35 | Tiranë | Kamëz | | | | | | | |
| 36 | Delvinë | | | | | | | | |
| 37 | Sarandë | | | | | | | | |
| 38 | Vlorë | Novosel | | | | + | | | |
| | Total | | | 1 | 5 | 6 | 1 | 9 | 9 |

FINANCIMI, MIKROFINANCA DHE PËRMIRËSIMI I LEGJISLACIONIT ME IMPAKT TË DREJTËPËRDREJT NË ZONAT RURALE

Shqipëria në dallim nga vendet e rajonit dhe më gjerë mbas ndryshimeve të sistemit e deri në vitin 2017 nuk e ka vlerësuar sa duhej rolin, rëndësinë dhe domosdoshmërinë që ka mbështetja e sektorit të bujqësisë dhe hallkave kryesore të Ekonomisë së Ushqimit me subvencione, me kredi e politika fiskale me kushte lehtësuese, me financimin e shpenzimeve dhe investimeve në sasinë e duhur nga buxheti, si dhe përmirësimin e legjislacionit për të lehtësuar veprimtarinë e fermerëve dhe plotësuar nevojat më minimale për plotësimin e objektivave të sektorit.

Situata e financimit nga viti 2017 e në vijim ka ndryshuar pozitivisht. Banka e Shqipërisë ka udhëzuar bankat e nivelit të dytë të rishikojnë dhe lehtësojnë politikat e kreditimit në drejtim të sektorit të bujqësisë dhe hallkave kryesore të fushës së Ekonomisë së Ushqimit.

Qevria shqiptare hoqi TVSH-në për inputet kryesore dhe traktorë e makineri që përdoren në bujqësi, për shumë paisje e materiale importi që përdoren në peshkim, për shërbimet veterinarë. Reduktoi me mbi 50 % çmimin e karburantit që përdorin fermerët për disa procese kryesore të punës në bujqësi. U rrit masa e financimit nga buxheti të shpenzimeve për bujqësinë nga 1.6 % që e financonte para vitit 2017 në 2.21% duke parashikuar një rritje të mëtejshme në planin financiar afatmesëm.

Bashkimi European së bashku me qeverinë shqiptare filluan dhe disbursuan nga viti 2017 deri tani përmes programit IPARD II, 94 milion euro grant.

Porgarmi IPARD III i financimit me grant i BE-së dhe qeverisë shqiptare është në proces miratimi me një shumë prej 146 milion euro.

Legjislacioni është përmirësuar në fushën e veterinarisë, bujqësisë organike, të prodhimit të verës dhe vreshtarisë, procesit të konsolidimit të pronësisë së tokës etj.

AIDA nëpërmjet shërbimeve të saj ka mbështetur financiarisht rreth 75 subjekte që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e bujqësisë përgjatë periudhës 2014 - 2019. Mbështetja financiare është kryer nëpërmjet fond-

eve që AIDA ka menaxhuar dhe që kanë pasur përputhshmëri me sektorin (Fondi i Konkurrueshmërisë; Fondi i Inovacionit; Fondi Start Up).

Shërbime të tjera që AIDA ka ofruar dhe ofron në mbështetje të biznesit vendas janë:

- Analiza sektoriale të tregut dhe sektorët e mundshëm për investime.
- Këshilla për gjetjen e pronave dhe vendndodhjeve të përshtatshme (në rastet kur kompanitë synojnë të zgjerohen ose të nisin një investim nga e para).
- Ndihma në identifikimin e projekteve të ardhshme dhe ekzistuese të investimeve në Shqipëri.
- Identifikimi i eksportuesve vendorë, partnerëve të biznesit ose kontakteve institucionale.
- Organizimi i aktiviteteve ndërmjetësuse dhe panai-reve kombëtre dhe ndërkombëtare.
- Grantet financiare dhe mundësitë e financimit nga projekte të ndryshme të BE-së, që kanë në fokus nxitjen dhe mbështetjen e prodhuesve shqiptarë për aksesin në tregje të reja.
- Portali B2B për gjetjen e partneriteteve potenciale.
- Portali Akses në Financë

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) është organizata ombrellë përfaqësuesja më madhe e sektorit privat. Shoqatat anëtare të KASH operojnë në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor, duke qenë në shumicë në zonat rurale. Gjithashtu, KASH është shoqata më e konsoliduar që mbulon spektrin kryesor në "Fushën e Ekonomisë së Ushqimit".

KASH mbron interesat e përbashkta të anëtarëve, i informon Ata për çështje me rëndësi dhe i asiston për njohjen e politikave fiskale. Ai prezanton kërkesat, shqetësimet dhe problemet e tyre institucioneve qendrore, donatorëve, shoqatave simotra, institucioneve të arsimit të lartë etj.

KASH në funksion të realizimit të objektivave për zhvillimin e zonave rurale bashkëpunon me Këshillin Ekonomik Kombëtar, Këshillin e Investimeve, Bordin Kombëtar të Ushqimit, Këshillin Kombëtar të Punës, Këshillin Koordinues të Shoqërisë Civile, Komitetin Kombëtar për Tregtinë e Lirë, Komitetin e Monitorimit të Programit "IPARD".

Enterprise Europe Network

AIDA, nëpërmjet zbatimit të Rrjetit European të Ndërmarrjeve në Shqipëri (EEN-Albania), mundëson për biznesin shqiptar mbështetje si:

- Marrëveshje ndërkombëtare (ekspertizë, kontakte, aktivitete për të lidhur kompanitë shqiptare me partnerë potencialë të huaj për të rritur biznesin e tyre).
- Këshillim për rritje ndërkombëtare (këshillim nga ekspertët për rritje dhe zgjerim në tregjet ndërkombëtare).
- Inovacioni në biznes (shërbime të orientuara nga zgjidhja për të ndihmuar kompanitë të kthejnë idetë e tyre inovative në suksese tregtare ndërkombëtare).



Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë,
Tel: +355 (0)42251001, Web: www.aida.gov.al, e-mail: info@aida.gov.al




Adresa: Rruga “Mine Peza”, Pallati 87/3, shkalla 2, kati i parë, Tiranë.
Tel/ 0682047365, E-mail; infokash@yahoo.com. agimrrapaj@yahoo.com



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001

